



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)
- \* Aktivitetet nga Programi për Stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive
  - \* Aktivitetet tjera

Qershor 2018

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Kontrata e sigurimit – kompensimi i dëmit dhe regresimi

Më 01 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Kontrata e sigurimit-kompensimi i dëmit dhe regresimi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kontratën e sigurimit në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan subjektet e të drejtës së sigurimeve, sigurimi nga auto-përgjegjësia, polica e sigurimit TPL dhe kufijtë e mbulesës si dhe kërkesa për kompensim të dëmit. Ndërsa në pjesën e dytë u vazhdua me trajtimin e shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial nga polica e sigurimit, e drejta në rentë dhe regresimi i dëmit.

Në trajnim u potencua se përcaktimi i saktë i përgjegjësisë së shkaktarit të dëmit dhe të drejtës së palës të dëmtuar në marrëdhënien juridike civile jokontraktuale është një prej sfidave të gjyqtareve të lëmisë civile, të cilët shqyrtojnë çështjet e kompensimit të dëmit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve me dispozitat e tij nga neni 136 deri në nenin 193, ka rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve jashtë-kontraktuale, respektivisht shkaktimin e dëmit dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të, veçmas dy llojet e shpërblimit të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi i dëmit jo material.

Në trajnim u potencua se për shkak të rëndësisë së veçantë, dhe duke u bazuar në faktin se dëmet më së shpeshti paraqiten në rastet e sigurimit nga auto përgjegjësia, këtu fokusi ishte te kontrata e sigurimit në fushën e auto përgjegjësisë dhe shpërblimi i dëmit si rrjedhojë e dëmeve të shkaktuara e të cilat janë të përfshira sipas mbulesës sigurorese, si dhe të

drejtën e regresit të dëmit të shpërblyer në rastet kur kjo mund të kërkohej.

Në vazhdim u veçua konstatimi se në praktikë gjykatat përballen me një numër të madh të lëndëve, ku kërkesë është shpërblimi i dëmit material edhe jo material, sidomos dëmet e shkaktuara nga aksidentet në komunikacion. Praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh rasteve nëpër gjykatat e Republikës së Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblimin e dëmit, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kritereve për përcaktimin e lartësisë së dëmit, posaçërisht atij jomaterial.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit së bashku me trajnuesit morën pjesë në një debat të frytshëm dhe interaktiv lidhur me pyetjet dhe paqartësitë e ngritura përmes analizës së dispozitave ligjore dhe mënyrave si duhet zbatuar drejtë ato në praktikë, gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik dhe raste nga praktika gjyqësore si dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Provat në procedurë penale

Më 5 qershor 2018, Akademinë e Drejtësisë në mbështetje të GIZ, ka realizuar trajnimin me temë “Provat në procedurë penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin, rëndësinë dhe vlerën provuese që kanë provat, për vërtetimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurë penale.

Ky trajnim trajtoj provat në procedurë penale që si rezultat i të provuarit nga ana e palëve do të nxirret edhe çështja e bindjes së gjyqtarit për pranimin, respektivisht besueshmërinë e një prove e cila argumenton ose jo një fakt të rëndësishëm juridik, për vërtetimin ose gjetjen e përgjegjësisë penale të pandehurve.

Sipas Kodit të Procedurës Penale gjyqtarit i mbetet të vlerësoj në tërësi cilësinë e provës, duke fituar bindjen se sa është e besueshme ajo provë, çfarë rëndësie dhe vlere provuese ka ajo provë për vërtetimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurë penale.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive i shoqëruar me shembuj praktik ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Barazia gjinore në rastet e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës

Më 07 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në mbështetje të GIZ, realizoi trajnimin me temë “Barazia gjinore në rastet e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me barazinë gjinore në rastet e trashëgimisë dhe në kontestet

nga marrëdhënia e punës.

Gjatë trajnimit u trajtua cenimi i pjesës së domosdoshme dhe procedura gjyqësore në rastet e cenimit, mos deklarimi i trashëgimtarëve dhe procedura pas shpalljes së trashëgimisë, diskriminimi në të drejtën e trashëgimisë në forma tjera si cenimi për së gjalli apo edhe ndarja faktike, diskriminimit në punë, mënyra e shfaqjes së diskriminimit mbi baza gjinore, mbrojta gjyqësore në rastet e diskriminimit mbi baza gjinore si dhe hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas specifikave të procedurës dhe rasteve.

Pjesëmarrës në trajnim ishin gjyqtarë të nivelit themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.





## Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parasë – Sesion I

Më 7 dhe 8 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e mbështetur nga BE-ja “Mbështetje e mëtejme për institucionet e Kosovës, në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm” të zbatuar nga B&S Europe, ka realizuar sesionin e parë të trajnimit me temë “Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parasë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për luftimin e shpëlarjes së parave, format apo veprimet që duhet ndërmarrë për luftimin e shpëlarjes së parave, si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë me qëllim që të zbatohen në mënyrë efektive mekanizmat përkatës.

Ky trajnim kishte për qëllim që të trajtoj veprat penale të shpëlarjes së parave të cilat bëjnë pjesë në krimet më serioze, që kanë për qëllim

që ta atakojnë zhvillimin ekonomik të shoqërisë. Si formë e kriminalitetit, shpëlarja e parave manifestohet në forma të ndryshme si: evazionet fiskale, aktivitete të ndryshme kriminale, pastrimi i parave, etj.

Të gjitha veprat penale që ndërlidhen me shpëlarjen e parave kryhen me ndërmarrjen e aktiviteteve kriminale. Këto vepra penale kërcënojnë seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, prokurorë nga Prokuroria Speciale, si dhe gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli themelor.



## Aktgjykimet dhe llojet e aktgjykimit sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore

Më 12 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Aktgjykimet dhe llojet e aktgjykimit sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me përmbajtjen, strukturën e aktgjykimit dhe llojet e tij.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan llojet e aktgjykimeve dhe kushtet për nxjerrjen e tyre, ndërsa në pjesën e dytë u vazhdua me trajtimin e përmbajtjes së aktgjykimit dhe rolin e secilit lloj të aktgjykimit.

Në trajnim u potencua se Ligji për Procedurën Kontestimore ka paraparë disa lloje të aktgjykimeve të cilat mund të nxjerrën nga gjykata, në rrethana të caktuara dhe në plotësimin e kushteve të veçanta procedurale. Vlerësimi i kushteve specifike për secilin lloj të aktgjykimit, nga ana e gjykatave, ka krijuar disa dilema të cilat po ndikojnë që në disa raste, gjykatat t’i vlerësojnë në mënyrë të gabuar, këto kushte e rrjedhimisht edhe të nxjerrin përfundime, përkatësisht aktgjykime me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore.

Në trajnim u potencua se me aktgjykim gjykata vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes

për çështjen kryesore, gjykata është e lidhur me kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendosë për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjykata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendosë për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë. Aktgjykimi përveç vendimit për çështjen kryesore përmban edhe vendimin për kërkesën aksesore.

Në vazhdim u veçua konstatimi se çështja e arsytimit të vendimeve gjyqësore është trajtuar në kuadër të jurisprudencës kushtetuese, ku është konsideruar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Lidhur me arsytimin e vendimeve edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka potencuar në një nga vendimet e saj, se: “Arsyetimi i aktgjykimit është një përbërës kyç i gjykimit të drejtë dhe është esencial për ndarjen e drejtësisë dhe është treguesi më i mirë që dëshmon se gjykatat i kanë të bazuara thënie të vendimet e tyre. Funkcion i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar”.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, diskutimeve, analizës së rasteve studimore, t’i zbërthejnë drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me aktgjykimin dhe llojet e tij. Gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik dhe raste nga praktika gjyqësore dhe mënyra të vendosjes meritore në raste konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore - departamentet e përgjithshme- divizioni civil.

## Personat juridik si kryes të kundërvajtjes

Më 14 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në mbështetje të GIZ, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temën “Personat juridik si kryes të kundërvajtjes”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, lidhur me legjislacionin e zbatueshëm rreth statusit juridik të subjekteve afariste në procedurën gjyqësore.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u elaboruan temat si: mënyra e zhvillimit të procedurës për

kundërvajtje ndaj subjektit afarist me cilësi të personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës në personin juridik, përgjegjësia e personit juridik dhe e personit përgjegjës të personit juridik, subjektet afariste si biznese individuale dhe zhvillimi i procedurës ligjore ndaj tyre dhe përgjegjësia e personit fizik.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga gjykatat themelore, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje.



## Masat e fshehta

Më 19 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Masat e fshehta”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth kornizës ligjore, e cila rregullon mënyrën e lëshimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, dhe procedurën e zbatimit dhe aplikimit të këtyre masave në drejtim të sqarimit të dilemave që ekzistojnë në praktikën gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u theksua rëndësia e këtyre masave dhe zbatimi i tyre i drejtë në praktikë, llojet e të gjitha masave dhe fazat e hetimit gjatë të cilave ato mund të autorizohen. Më tej u trajtuan kushtet ligjore, personat e autorizuar për

lëshimin e masave të fshehta, hartimi i urdhrave për zbatim të masave dhe përmbajtja e kërkesës për marrjen e këtyre urdhrave për autorizimin e masave si dhe kohëzgjatja e këtyre masave. Në këtë kontekst u shtjelluan kompetencat e policisë, prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake.

Metodologjia e trajnimit ishte një kombinim i teorisë dhe rasteve praktike të parashtruara nga trajnuesit me qëllim të kontributit në unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët të nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovë.





## Masat edukative dhe dënimet

Më 26 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në mbështetjen e UNICEF, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë: “Masat edukative dhe dënimet”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe elaborimit të rasteve nga praktika, të ngritën kapacitetet profesionale të pjesëmarrësve për shqiptimin e masave të edukative dhe dënimeve.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua qëllimi i masave edukative dhe përfitimet e aplikimit të

tyre, llojet e këtyre masave, ku u shtjelluan në mënyrë të hollësishme secila nga masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar si dhe masat edukative institucionale.

Më tej, trajnimi ka vazhduar duke diskutuar për kushtet ligjore dhe kriteret që vlerëson gjykata me rastin e shqiptimit të njëjës nga masat, përcaktimi i kohëzgjatjes së tyre, si dhe roli i tyre në shmangien nga stigmatizimi i të miturve. Paraprakisht vëmendje iu kushtua edhe trajtimit të dënimeve të cilat mund t'i shqiptohen një të mituri i cili ka kryer veprë penale e cila është e ndëshkueshme me 5 vite e më shumë burgim.

Trajnimi ishte i formatit ndërveprues, me diskutime nga ana e pjesëmarrësve për çështjet në fokus të këtij trajnimi, si dhe u prezantuan raste praktike dhe hipotetike nga ana e trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, nga Departamenti për të Mitur, nga regionet të ndryshme të Kosovës



## Bazat juridike për caktimin përmbartimit

Më 28 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Bazat juridike për caktimin përmbartimit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me bazat juridike për caktimin përmbartimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan roli dhe rëndësia e organit përmbartues, vendimet, mjetet dhe objekti i përmbartimit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan bazat juridike për caktimin e përmbartimit dhe veprimet e organit përmbartues, në këtë kontekst se çka duhet të përmbajtë propozimi për përmbartim, procedurën e shqyrtimit të propozimit, procedurën e caktimit të përmbartimit, përmbajtjen e aktvendimit për përmbartim dhe urdhrin për përmbartim.

Në vazhdim të trajnimit u potencua se Ligji për Trashëgiminë ka paraparë bazat për thirrje në trashëgimi, rendet ligjore të trashëgimisë, procedurën gjyqësore e cila ka të bëjë me shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarët e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë. Ndërsa në praktikën gjyqësore ka vështirësi dhe dilema rreth përcaktimit të vëllimit të pjesës së domosdoshme dhe personave që e gëzojnë këtë të drejtë, por edhe në çështjet që kanë të bëjnë me bazat e thirrjes në trashëgimi dhe rendet ligjore të trashëgimisë.

Gjithashtu ky trajnim kontribuoj në heqjen e dilemave dhe në unifikimin e praktikës gjyqësore për çështjet e cekura më lartë, posaçërisht në pjesën që ka të bëjë me kompetencën në lidhje me kryerjen e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykatat apo noterët (për shkak të mos harmonizimit të

dispozitave ligjore të Ligjit për Trashëgiminë dhe Ligjit për Procedurën Jokontestimore me Ligjin për Noterinë). Në vazhdim u veçua mendimi se vonesat e mëdha në përmbartimin e aktgjykimeve civile në gjykatat në Kosovë, dëmtojnë rëndë të drejtën për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme dhe në përgjithësi sundimin e ligjit.



Ndërsa për sistemin privat të përmbartimit u potencua se ka gjithashtu përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbartimit nga gjyqtarët dhe zyrtarëve përmbartues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agentëve privat, por roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm sepse çështjet më të ndjeshme siç janë çështjet familjare, mbesin kompetencë ekskluzive e gjykatave, po ashtu mjetet juridike mbesin në vendosje të gjykatave si dhe funksioni tjetër i rëndësishëm-mbikëqyrja.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, diskutimeve, analizës së rasteve studimore, t'i zbërthejnë drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore - departamentet e përgjithshme - divizionet civile.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Aktivite e realizuara në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit qershor 2018 janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga modulet: “E drejta civile, ekonomike dhe administrative” dhe “Shkathësitë personale dhe ndër personale”.

Nga nën moduli “E drejta ekonomike” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar: specifikat e procedurës kontestimore në kontestet ekonomike, shoqëritë tregtare, falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi i personave juridikë, kontratat në ekonomi, punët bankare dhe siguruese dhe të drejtat nga pronësia intelektuale.

Në kuadër të nën modulit “E drejta pronësisë dhe të drejtat tjera sendore janë realizuar shtatë (7) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapoemëruar kanë zhvilluar kompetencën profesionale mbi këto çështje: të drejtën e pronësisë në shumë subjekte; bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët; mënyrat e fitimit

të pronësisë; llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë dhe mënyrat e humbjes së saj. Po ashtu në kuadër të këtij nën moduli është realizuar dhe një (1) një sesion trajnues nga e drejta e detyrimeve lidhur me padinë tek pasurimi i pa bazë, ku pjesëmarrësit kanë zhvilluar shkathësitë e tyre praktike duke hartuar aktgjykim lidhur me këtë padi.

Në këtë periudhë raportuese nga nën moduli “Arsyetimi i vendimeve gjyqësore” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese në lëmin penale ku pjesëmarrësit kanë trajtuar rëndësinë e shkrimit ligjor, tiparet që e bëjnë të qëndrueshëm, dhe komponenti analitik. Ndërsa në kuadër të nën modulit “Rregullat e komunikimit” janë realizuar dy (2) sesione trajnues ku janë trajtuar rregullat e brendshme të jashtëm dhe përvojat më të mira në mjedisin e punës.



## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit qershor 2018, trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar është realizuar sipas programit trajnues. Në këtë periudhë janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga modulet: “Kodi Penal” dhe “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli “Kallëzimi penal” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar: Kallëzimi penal i policisë dhe nga burimet tjera, veprimet e prokurorit lidhur me kallëzimi penal, të dhënat plotësuese dhe hudsonja e kallëzimit penal.

Në kuadër të nën moduli “Aktakuza – procedura e shqyrtimit” janë realizuar shtatë (7) sesione trajnuese ku prokurorët e shtetit të sapoemëruar kanë trajtuar këto çështje: Të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës, ndryshimi, zgjerimi dhe hudsonja e aktakuzës, përfaqësimi i aktakuzës nga prokurori i shtetit në fazat e shqyrtimit gjyqësor, propozimet ndaj kryerësve të veprave

penale me çrregullime mendore, propozimet ndaj të miturve si kryerës të veprave penale, aktakuza me propozim për paraburgim dhe sfidat e prokurorit të shtetit, në aspektin e ekspertimit mjeko-ligjor me rastin e ngritjes së aktakuzës.

Gjithashtu në kuadër të nën modulit “Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë trajtuar: kushtet ligjore për autorizimin e masave të fshehta dhe të drejtat e personave të atakuar, përgjimi i telekomunikimeve dhe regjistrimi i bisedave telefonike, hetimi i fshehtë dhe zbulim i të dhënave financiare.

Ndërsa nga nën moduli “Krimet e rënda” është realizuar një (1) sesion trajnues ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohurit mbi infrastrukturën ligjore lidhur me trafikimin me njerëz, shpëlarjes së parave dhe krimeve kibernetike.





## Trajnim praktik i gjyqtarëve të sapoemëruar të Agjencinë Kundër Korrupsionit

Më datën 6 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar një vizitë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin detyrat dhe përgjegjësitë të këtij institucioni.

Në kuadër të kësaj vizite u bashkëbisedua lidhur me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, personat e dyshuar për veprime korruptive, kallëzimet penale te institucionet përkatëse, si Prokuroria e Shtetit, Policia e Kosovës, rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale, zhvillimi i hetimeve, pushimi i hetimeve, hedhja poshtë e rasteve.

Njëkohësisht, u trajtuan konflikti i interesit, deklarimi dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave, llojet e deklarimit të pasurisë, deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik, kontrolli i deklarimit të pasurisë, si dhe parandalimi i konfliktit të interesit.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç'rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të bëjnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.





## Trajnim praktik në Zyrën Kombëtare të Auditimit

Më datën 13 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Qëllimi i trajnimit ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të krijojnë një pasqyrë të qartë rreth mandatit, rolit, strukturës organizative dhe përgjegjësisë të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Fillimisht, në kuadër të kësaj vizite, Drejtori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, prezantoi një historik të shkurtër të themelimit dhe zhvillimit, mandatin dhe funksionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe punës audituese që kryen si dhe për bashkëpunimin me legjislativin dhe organet e drejtësisë. Po ashtu u përmendën sfidat dhe vështirësitë me të cilat

aktualisht ballafaqohen në përmbushje e mandatit të tyre ligjor.

Gjithashtu, në mënyrë të hollësishme u trajtua pavarësia e Zyrës Kombëtare të Auditimit, funksionet e brendshme dhe të jashtme të auditimit, si dhe auditimi i rregullsisë dhe performancës.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç'rast gjyqtarët e sapoemëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



## Aktivitetet në Programin për Hulumtime dhe Publikime

### Tryezë me gjyqtarë

Me 01 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të Projektit për Reformë Ligjore dhe Administrative të GIZ, ka realizuar tryezën e dytë me radhë me gjyqtarë me temë: “Manuali i Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe referimi në të nga gjykatat e rregullta”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i punës së deri tanishme në hartimin e manualit për Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe diskutimi me gjyqtarët pjesëmarrës për nevojën e përdorimit të këtij manuali.

Gjatë kësaj tryeze u diskutua për qëllimin e zhvillimit të këtij manuali, metodologjinë e cila është përdorë me rastin e hartimit, rastet të cilat janë elaboruar dhe fushat të cilat ndikohen, si dhe çështje tjera rreth manualit. Vëmendje të veçantë gjatë kësaj tryeze ishte arsyeshmëria e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut e cila

është mbresëlënëse për gjithë juristët, të cilat ishin integruar në manual për secilin nen të konventës, duke bërë të mundur zbatimin më të lehtë të kësaj praktike nga ana e gjyqtarëve të Kosovës.

Gjyqtarët pjesëmarrës u shprehën të kënaqur me punën e deritanishme të këtij manuali, dhe njëkohësisht parashtruan nevojën e përdorimit të tij me qenë se të drejtat e njeriut janë të integruara edhe në Kushtetutën e Kosovës si dhe orientimi i Kosovës për integrim në BE.

Pas përfundimit të draftit të këtij manuali do të organizohet një punëtori për mënyrën e përdorimit të manualit.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin gjyqtarët nga gjitha Gjykatat e Kosovës kryesisht nga Gjykatat Themelore.



## Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

### Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore

Më 05-06 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë e përkrahur nga Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor” organizoj trajnimin me temë: “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të stafit profesional dhe administrativ të gjykatave dhe prokurorive në Republikën e Kosovës, lidhur me shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: shqyrtimi paraprak i padisë, vlerësimi i aktakuzës dhe mënyrat e veprimit pas vlerësimit të aktakuzës, veprimet për evitimin e pengesave procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe aktet gjyqësore në shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë dhe shqyrtimin gjyqësor.

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan temat: procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor, shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC, pyetje të strukturuar, shembuj të vendimeve dhe rasteve praktike, procesi analitik dhe rëndësia e tij, sfidat analitike, analiza e shkruar ligjore, struktura dhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit dhe udhëzime për shkrimin e arsyetimit të aktgjykimeve.

Gjatë trajnimit duke elaboruar etapën e shqyrtimit paraprak të padisë dhe veprimet që mund të ndërmerren gjykata, fokusi u orientua në: prezumimet procedurale lidhur me gjykatën,

shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën, kompetenca e gjykatave themelore, kompetenca lëndore, kur dhe si duhet ta vlerësoj kompetencën gjyqtari i çështjes, kompetenca territoriale, prezumimet procedurale lidhur me palët, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i përkohshëm dhe përfaqësimi i rregullt i personit juridik.

Gjithashtu u trajtuan disa nga çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë dhe shqyrtimin gjyqësor. Në këtë aspekt, janë zbërthyer temat që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar, kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhjen e aktakuzës, aktvendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues, shqyrtimin e dytë, përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, publicitetin e shqyrtimit gjyqësor, zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, shtyrjen, ndërprerjen dhe afatet e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, etj. Përfitues në këtë trajnim ishin staf i bashkëpunëtorëve profesional dhe administrativ në gjykata dhe prokuroritë e Kosovës në të gjitha nivelet.

## Shkathtësitë e hulumtimit ligjor

Më 11 Qershor 2018, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit të Binjakëzimit "Mbështetje e mëtejme për Reformën e Arsimit Ligjor" dhe GIZ, realizoj trajnimin për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial nga Moduli 3 "Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore", konkretisht nën modulën 1: Shkathtësitë e hulumtimit ligjor.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e shkathtësive të pjesëmarrësve lidhur me teknikat e ndryshme të hulumtimit ligjor.

Në fokus të trajnimit ishin teknikat e hulumtimit ligjor, shkrimi dhe arsyetimi ligjor si parakushte për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në zbatimin e kompetencave gjyqësore dhe prokuroriale për të trajtuar me kohë dhe në mënyrë profesionale çështjet e ngritura.

Në trajnim vëmendje iu kushtua veprimeve të cilat duhet të ndërmerren me rastin e fillimit të një procedure, cilat veprime duhet të ndërmerren për përgatitjen e fazave pasuese pas fillimit të procedurës, si mund të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore dhe cila është struktura dhe përmbajtja e vendimeve gjyqësore sipas dispozitave ligjore.

Në kuadër të këtij trajnimi janë dhënë udhëzimet teorike dhe praktike lidhur me shkathtësitë e hulumtimit ligjor, shkathtësitë e trajtimit të rasteve dhe shkathtësitë për shkrimin e arsyetimit ligjor, sipas metodave dhe standardeve që garantojnë objektivitet, siguri, cilësi dhe efikasitet.

Përfitues të trajnimit ishin bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor dhe asistente ekzekutive.





## Aktivitetet tjera

### E drejta administrative dhe konflikti administrativ

Më 5 - 6 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së ka vazhduar trajnimin e katërt me radhë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “E drejta administrative dhe konflikti administrativ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me rastin e ofrimit të ndihmës juridike palëve në rastet e natyrës administrative.

Në ditën e parë janë trajtuar parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kompetencat e organit për zhvillimin e procedurës, procedura para nxjerrjes së aktit administrativ, akti administrativ, mjetet juridike si dhe ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ.

Në ditën e dytë janë trajtuar çështjet rreth inicimit të konfliktit administrativ, aktgjykimi ankesat si dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Gjatë trajnimit kishte diskutime interaktive veçanërisht në raste praktike dhe çështjet që ishin preokupim i zyrtarëve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe nga OJQ si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive te Gjakovës.





## Procedura kontestimore

Më 11 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së, ka vazhduar trajnimin e pestë me radhë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Procedura kontestimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit paraprak të padisë dhe seancës përgatitore si dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore në përgjithësi, nga ana e ofruesve të ndihmës juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan parimet e procedurës kontestimore, kompetenca e gjykatës dhe llojet e saj, parashtrësat dhe dërgimi i tyre, padia dhe llojet e saj, seancat dhe afatet, mjetet provuese dhe marrja e provave, llojet e vendimeve gjyqësore, sigurimi i kërkesëpadisë, mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, si dhe procedurat e veçanta.

Gjatë trajnimit pati diskutime të shumta me theks të veçantë te kontestet e punës, veçanërisht për realizimin e pagës jubilarë dhe përcjellëse, për të cilat u dhanë sqarime nga ana e trajnuesve për mënyrën se si duhet trajtuar këto raste, si dhe afatet që duhet respektuar me qëllim të përfundimit të suksesshëm të rasteve. Gjithashtu pati edhe diskutime edhe për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë duke qenë se ofruesit e ndihmës juridike falas kishin raste të shumta gjatë punës së tyre.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe nga OJQ si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive të Gjakovës si dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit.



## Procedura jokontestimore

Më 12 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së ka vazhduar trajnimin e gjashtë me radhë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Procedura jokontestimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i Ligjit të Procedurës Jokontestimore nga ana e zyrtarëve që ofrojnë ndihmë juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan dispozitat e përgjithshme të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, shpallja e zhdukjes së një personi, procedura e shpalljes së vdekjes së një personi, procedura e të provuarit të vdekjes, caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, rregullimi i mezhdës, ndarja fizike si dhe e drejta e trashëgimisë dhe procedura e shqyrtimit të

trashëgimisë.

Gjatë trajnimit kishte diskutime të shumta me theks te bashkëpunimi me qendrat sociale, organin e kujdestarisë meqë këto ishin rastet më të shumta ku zyrtarët e ndihmës juridike ballafaqohen në punën e përditshme.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe pjesëmarrës nga OJQ si CRPK, CLARD dhe Femrat Aktive të Gjakovës si dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit.



## Trajnimi i Trajnuesve Trajnimi i bazuar në raste praktike

Më 12 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme për Reformën e Arsimit Ligjor” i financuar nga BE, realizoj trajnimin për trajnues “Trajnimi i bazuar në raste praktike”.

Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të trajnuesve rreth metodologjisë trajnuese, në mënyrë që kur do të angazhohen trajnues, ti zbatojnë teknikat dhe metodat më të avancuara të trajnimit me raste praktike.

Trajnimi u fokusuan kryesisht në atë se si të realizohet një trajnim me raste praktike. Paraprakisht në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan edhe përcaktimi i synimeve për mësim

dhe përgatitja e rasteve praktike të cilat në praktik duhet realizuar përmes punëtorisë interaktive me përfituesit e trajnimit.

Vëmendje iu kushtua Doracakut për trajnimin e bazuar në raste, i cili do të ju shërbej trajnuesve si udhërrefues për përgatitjen dhe zbatimin në praktikë të rasteve, kur të shtjellohet tema përkatëse në kuadër të programeve trajnuese të Akademisë së Drejtësisë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli i Apelit dhe ai themelor, trajnues të Akademisë së Drejtësisë.



## Procedura përmbarimore

Më 13 qershor 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së ka vazhduar trajnimin e shtatë me radhë dhe të fundit në këtë cikël, për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Procedura përmbarimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore që i referohen përmbarimit nga ana e ofruesve të ndihmës juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me kompetencën e organit përmbarues konkretisht gjykatës dhe përmbaruesit privat, dokumenti përmbarimor dhe dokumenti i besueshëm, propozimi për përmbarim, zbatimi i përmbarimit, shtyrja, pezullimi dhe përfundimi i përmbarimit, përmbarimi në sende të luajtshme dhe xhirollogari bankare, detyrimet bankare si dhe mjetet e rregullta juridike.

Gjatë trajnimit pati diskutime të shumta me theks të veçantë kur në cilësi të debitorit janë personat me asistencë sociale si dhe ata që janë në pension. Gjithashtu pati edhe diskutime edhe tek çështjet e alimentacionit në rastet kur nuk pëmbushet detyrimi për alimentacionin. Të gjitha këto raste, përfshirë edhe raste tjera, u adresuan nga ana e trajnuesve në kuptim të zgjidhjeve që ofron Ligji i Procedurës Përmbarimore.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe pjesëmarrës nga OJQ si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive të Gjakovës si dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit.





## Program shkëmbimi në Gjermani lidhur me trajnimin fillestarë të bazuar në raste

Nga data 19-23 qershor 2018, në Koblenz dhe Mainz të Gjermanisë, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për edukim ligjor”, është realizuar një program shkëmbimi, lidhur me trajnimin e bazuar në raste si një qasje efektive për trajnim profesional dhe edukim me fokus në trajnimin fillestar.



Qëllimi i vizitës ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procesin e të mësuarit, organizimin e trajnimit fillestar të bazuar në kompetenca dhe në vendin e punës si dhe metodat dhe mjetet e përdorura për realizimin e këtij trajnimi.

Dita e parë e këtij programi u realizua në Gjykatën Rajonale të shkallës së dytë në Koblenz, ku delegacioni u prit për një fjalë përshëndetëse nga Kryetarja e gjykatës, duke vazhduar me prezantimin e punës që nga pranimi i lëndëve, natyra, dhe mënyra e trajtimit nga kjo gjykatë.

Gjatë këtij programi pjesëmarrësit patën rastin të ndjekin sesione praktike të trajnimit fillestar të zhvilluar sipas metodologjisë së theksuar më lartë, e cila ju mundëson kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë praktike lidhur me detyrat kryesore të tyre.

Fokusi i kësaj metodologjie qëndron në format e trajnimit interaktiv dhe simulime, dhe në dy seanca reale gjyqësore në lëmin civile dhe penale të cilat delegacioni nga Akademia e Drejtësisë kishte rastin ti përcjellë nga afër.

Gjatë qëndrimit në Mainz, delegacioni u prit edhe nga Sekretari i Ministrisë së Drejtësisë së landit Rheinland –Pfalz, i cili vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm si dhe u zotua për bashkëpunimin edhe në të ardhmen në mes të dy shteteve dhe institucioneve përkatëse.

Përfitues të vizitës ishin tre gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Koordinatorin e Programit dhe Udhëheqja e Programit të Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë, të cilët në mbështetje të projektit të Binjakëzimit kanë punuar për një kohë të gjatë në krijimin e sistemit për zbatim të trajnimeve fillestare bazuar në raste.





## Trajnimi i mbështetur nga EJTN, “Të drejtat e njeriut dhe qasja në drejtësi në Bashkimin Evropian”

Më 26-27 qershor 2018, në Bukuresht të Rumanisë – në Institutin Kombëtar të Magjistraturës, me mbështetjen e EJTN-Rrjeti Evropian për Trajnime Gjyqësore, e në kuadër të Projektit për të Drejtat e Njeriut dhe ato Themelore, është realizuar një trajnim për gjyqtarë dhe prokurorë në nivel të shteteve anëtare të BE-së, me pjesëmarrjen edhe të vëndëve nga Ballkani Perëndimor, me temë “Të Drejtat e Njeriut dhe Qasja në Drejtësi në Bashkimin Evropian”.

Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e njohurive dhe shkathtësive teorike dhe praktike të gjyqtarëve, lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, dhe nocionin e mjeteve efektive, si të drejta themelore të përcaktuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 47 të Kartës së

Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

Objektivë e trajnimit ishte që përmes kombinimit të pjesës teorike dhe punëtorisë me raste nga praktika gjyqësore pjesëmarrësit të adresojnë çështjet si: pavarësia gjyqësore, parimi i barazisë së armëve dhe kohëzgjatja e procedurës gjyqësoreve, si dhe që ky trajnim të shërbejë si një forum për shkëmbim të njohurive dhe praktikave më të mira në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian.

Nga Kosova përfituese e këtij trajnimi ishte gjyqtarja Lumnije Krasniqi, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Divizioni Penal, Departamenti i Përgjithshëm.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**